Kronikë

# Dibër/ Plagosi aksidentalisht 15-vjeçarin, arrestohet 21-vjeçari! Fshehu kallashnikovin, pushkën dhe fishekët në një shkëmb

*Një 21-vjeçar i identifikuar si Korab Visha është arrestuar nga policia e Dibrës pasi plagosi aksidentalisht me kallashnikov një 15-vjeçar në fshatin Ceren. Pas ngjarjes, fshehu 2 armët dhe fishekët në një shkëmb.*



*Vendi ku ndodhi plagosja dhe armët e sekuestruara*

[Sh].com Redaksia
16 Nëntor, 10:43 | **Përditesimi: 16 Nëntor, 10:47**

Një 21-vjeçar i identifikuar si Korab Visha është arrestuar nga policia e Dibrës pasi plagosi aksidentalisht me kallashnikov një 15-vjeçar në fshatin Ceren. Pas ngjarjes, fshehu 2 armët dhe fishekët në një shkëmb.

**Njoftimi i policisë**


LEXO EDHE:
**I mbanin në stalla më pas i shisnin, arrestohen 4 persona në Dibër, kontrabandonin bagëti nga Maqedonia e Veriut**

Plagosi aksidentalisht, me armë zjarri, 15-vjeçarin, dhe më pas fshehu armën e krimit, Policia e Dibrës zbardh ngjarjen dhe vë në pranga 21-vjeçarin.  Procedohet penalisht edhe një shtetas tjetër, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit". Policia gjen të fshehura në mal, 2 armë zjarri (kallashnikov dhe pushkë).

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Dibër, pas marrjes së njoftimit se një shtetas kishte shkuar në spital, i dëmtuar, dyshohej me armë zjarri, kanë organizuar punën për zbardhjen e ngjarjes.

Falë veprimeve të shpejta profesionale dhe hetimore, të kryera nga grupi hetimor, në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, u bë e mundur zbardhja e rrethanave të ngjarjes.

Nga hetimet rezultoi se shtetasi K. V., 21 vjeç, mbi fshatin Ceren, në njësinë administrative Kala e Dodës, dyshohet se ka plagosur aksidentalisht me armë zjarri 15-vjecarin, banues në fshatin Ceren, i cili ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Menjëherë pas ngjarjes, 21-vjecari ka fshehur në një shkëmb mbi fshatin Ceren, dy armë zjarri, kallashnikov dhe pushkë (me njërën nga të cilat dyshohet se ka plagosur 15-vjeçarin), si dhe një sasi municioni luftarak.

Në përfundim të veprimeve, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Dibër kanë bërë arrestimin në flagrancë të shtetasit K. V., 21 vjeç, banues në fshatin Ceren, Dibër, për veprat penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit" dhe "Plagosja e rëndë nga pakujdesia".

Gjithashtu, në vijim të veprimeve u referuan materialet në prokurori dhe nisi procedimi në gjendje të lirë, për shtetasin A. L., 21 vjeç, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit", pasi ka qenë i pranishëm gjatë ngjarjes, por nuk ka kallëzuar krimin. Materialet proceduriale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gyqësor Dibër, për veprime të mëtejshme.

Në përditësim...



A.M./r.k./Shqiptarja.com

TAG: Diber | korab visha | plagosje

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

**Sondazhi i ditës:**
**Debati, kush ka të drejtë për projektin e Portit të ri të Durrësit?**

Queveria | Opozita | Nuk kam mendim







## Lajme të tjera


Yuri Kim shkon në malet e Dibrës: Mësova si bënin jufkat dhe vizitova vendlindjen e Skënderbeut
14 Nëntor, 20:48


Bllokohet rruga Klos-Bulqizë, shkak bëhet thyerja e disa pllakave me xhama (VIDEO)
11 Nëntor, 11:14


Minierat dëmtojnë pyjet, policia patrullim natën në Bulqizë! Drejtori i Pyjores: Po mbjellim 2300 pisha në thekër
Mahir Jangulli
7 Nëntor, 16:56



Plagoset me thikë në gjoks i riu shqiptar në Itali, policia: E sulmuan dy bashkëatdhetarë për të larë hesapet
7 Nëntor, 14:03


Plagosi vjehrrin dhe vjehrrën në 2017, ekstradohet nga SHBA 40-vjeçari! I dënuar me 25 vite burg (FOTO)
6 Nëntor, 09:27



Zhduket pa lënë gjurmë shqiptari në Greqi pas plagosjes së partneres! Familjarët: Mund të jetë në rrezik për jetën
6 Nëntor, 09:13


Çmim i ulët në treg, mollët e Dibrës kalben në pemë! Fermerët: Me 20-30 lekë për kg, nuk nxjerrim as shpenzimet
Mahir Jangulli
5 Nëntor, 14:52


E rëndë në Greqi, 5 banditë shqiptarë plaçkisin dhe plagosin bashkëatdhetarët në një rezidencë në Mykonos! Ja dolën të arratisen me 40 mijë euro
3 Nëntor, 12:06


I riu plagos 47-vjeçarin në Tiranë, e shqetësoi zhurma që po bënin kur po luanin domino (VIDEO)
1 Nëntor, 18:17


Sherr mes gjimnazistëve në Durrës, plagoset me thikë në shpatull 16-vjeçari (VIDEO)
1 Nëntor, 13:38


45 vite këpucar, 61-vjeçari nga Dibra: Zanati më jep lumturi! S'të bën pasanik, po s'të lë pa lekë
Mahir Jangulli
30 Tetor, 14:57


Rama-opozitës: Flasim për ujë të pijshëm në shek.21, por po shërojmë plagët që la partia e rublave! Dibra 24 orë me ujë, në pranverë edhe Mati
30 Tetor, 14:12



© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje